



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN / MUNICIPALITY OF LIPJAN



Drejtoria i Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Datë/Datum/ Date:	06.12.2024
Për/Za/For:	z. Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës së Lipjanit
CC:	z. Diamant Bytyqi – Nënkyetar i Komunës z. Lulzim Qerimi – Nënkyetar i Komunës z. Avni Jashari - Shef i Kabinetit të Kryetarit
Nga/Od/From	z. Rexhep Rexhepi - Drejtori i Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari
Lënda/Subjecat/Subject:	Raporti për muajin Nëntor

I nderuar Kryetar Z. Imri Ahmeti,

Të bashkangjitur gjeni Raportin mujor të aktiviteteve të Drejtoratit të Bujqësisë dhe Pylltarisë për periudhën nga 01.11.2024 deri me 30.11.2024

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

SEKTORI I BUJQËSIË

Përmes këtij raporti po shfaqim disa nga përmbledhjet dhe aktivitetet kryesore të realizuara gjatë muajit nëntor nga Drejtorati i Bujqësisë dhe Pylltarisë.

- Gjatë muajit Nëntor kemi filluar procedurat për kontrat të re për trajtimin e qëneve endacak, ku presim që shumë shpejt të përfundohet me këtë process dhe të jemi gati për sezonin dimëror.
- Komisioni për vlerësimin e lëndëve të aplikuesve për sera dhe për Motokultivator ka përfunduar punën e tyre dhe kanë publikuar Lista e përfituesve që është në bashkëfinancim me organizatën IRK është planifikuar të shpërndahen tek përfituesit gjatë muajit Dhjetor ndërsa lista pritëse e përfituesve nga Komuna e Lipjanit pritët të shpërndahen tek përfituesit gjatë prnverë së vitit 2025.
- Gjithashtu gjatë Muajit Nëntor kemi bërë shpërndarejn e mekanizmit bujqësore dhe Serave bashkë me organizatën IADK. Gjithashtu Ky projekt dhe ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2025.
- Gjithashtu gjatë Muajit Nëntor kemi rifilluar procedurat e prokurimit për blerjen e serave me sipërfaqe 100m², presim që të fillojmë menjëher pas lidhjes së kontratës me operatorin fitues montimin e serave tek përfituesit.
- Komisioni nga drejtorati i bujqësisë ka vazhduar me kompletimin e lëndëve të fermerëve të cilët kanë pasur dëme gjatë vitit 2024.
- Gjithashtu po i njejt komision ka kompletuar edhe lëndët e fermerëve të cilët kanë pasur dëme nga vërshimet e vitit 2023 të cilat do ti mbulojë departamenti për Emergjenca.
- Edhe gjatë muajit nëntor kemi vazhduar me zhavorimin e rrugëve të kategoris së 4-të apo rrugëve fushore.
- Komisioni komunal nga Drejtorati i bujqësisë është duke dalur në teren sipas kërkesave të fermerëve të cilët kanë pësuar dëme.
- Përveç tjerash, gjithashtu jemi duke bërë monitorimin e përfituesve në teren të cilët kanë qenë përfitues të mekanizmit të ndryshëm.
- Montimi i serave është duke vazhduar dhe presim që deri në javën e parë të Dhjetorit të përfundohen.

Me që jemi në përfundim të vitit 2024, drejtorati për bujqësi dhe pylltari ka realizuar shumicën e projekteve të parapara, gjithashtu jemi në procedur për vazhdimin e montimi të serave nga komuna por presim qe deri në mes të muajit dhjetor të I përfundojmë të gjitha projektet.